



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**

V E N D I M

**PËR NGRITJEN E KOMISIONEVE TË ZONAVE TË ADMINISTRIMIT ZGJEDHOR PËR
ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 30.06.2019 DHE
THIRRJEN E MBLEDHJES SË PARË TË TYRE**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e tij të datës 09.04.2019, me pjesëmarrjen e:

| | | |
|---------|-----------|-----------------|
| Klement | ZGURI - | Kryetar |
| Denar | BIBA - | Zëvendëskryetar |
| Bledar | SKËNDERI- | Anëtar |
| Edlira | JORGAQI- | Anëtare |
| Rezarta | BITRI- | Anëtare |

shqyrtoi çështjen me:

OBJEKT: Ngritja e Komisioneve të Zonave të Administrimit Zgjedhor për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019, dhe thirrja e mbledhjes së parë të tyre.

BAZA LIGJORE: Neni 23, pika 1, gërma "a", neni 28, pika 1, të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur si dhe dëgjoji diskutimet e përfaqësuesve të partive politike;

VËREN

Kodi Zgjedhor në nenin 28 pika 1, përcakton që KQZ-ja merr vendim për ngritjen e KZAZ-ve, jo më vonë së 90 ditë para datës së zgjedhjeve. Ky afat nuk u arrit të respektohej për shkak të vakancave në KZAZ, krijuar nga mos paraqitja e propozimeve nga partitë politike të opozitës parlamentare.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, plotësoi vakancat përmes emërimeve kryesisht të anëtarit të KZAZ-së me numër tek, dhe sekretarit të KZAZ-së me numër çift, duke respektuar procedurat e



Nr.142 i Vendimit Data 09 .04.2019 e Vendimit Ora 11⁰⁰

Për ngritjen e Komisioneve të Zonave të Administrimit Zgjedhor për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019, dhe thirrjen e mbledhjes së parë të tyre

përcaktuara në Udhëzimin nr. 4, datë 19.02.2013 "Për procedurat e përzgjedhjes dhe trajnimit të shtetasve që mund të emërohen kryesisht nga KQZ, për plotësimin e vakancës së krijuar në KZAZ dhe KQV", i ndryshuar.

Emërimet kryesisht nga KQZ plotësojnë vakancat në KZAZ, të cilat kanë numrin e nevojshëm të anëtarëve për vendimarrje dhe kanë në detyrë sekretarin.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në zbatim të nenit 19, të Udhëzimit nr. 2, datë 25.02.2009 "Për organizimin dhe funksionimin e KZAZ-ve", i ndryshuar, me vendim cakton thirrjen e mbledhjes së parë të KZAZ-ve, duke përcaktuar datën, vendin dhe orën.

PËR KËTO ARSYE

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, bazuar në nenin 23, pika 1, gërma "a", nenin 28, pika 1, të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë,

V E N D O S I:

1. Ngritjen e Komisioneve të Zonave të Administrimit Zgjedhor, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019.
2. Mbledhja e parë e Komisioneve të Zonave të Administrimit Zgjedhor, të zhvillohet ditën e enjte dhe ditën e premte, datë 11 dhe 12 Prill 2019, ora 10.⁰⁰ në Selitë e KZAZ-ve.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

| | | |
|----------------|------------------|-------------------|
| Klement | ZGURI - | Kryetar |
| Denar | BIBA - | Zv/Kryetar |
| Bledar | SKËNDERI- | Anëtar |
| Edlira | JORGAQI- | Anëtare |
| Rezarta | BITRI- | Anëtare |



Nr.142 i Vendimit Data 09 .04.2019 e Vendimit Ora 11⁰⁰

Për ngritjen e Komisioneve të Zonave të Administrimit Zgjedhor për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019, dhe thirrjen e mbledhjes së parë të tyre